




POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



1 Ndalohet nga jeta imazhi i Bashkimit Sovjetik, Igor Kirillov. Njeriu që theksoi ndryshimin mes profesionistit dhe gazetarit të thjeshtë



2 Komentuesit 'masakrojnë' Berishën: Keni gënjer, padia nuk është pranuar në gjykatën e Parisit! Për interesin personal po shkatërron PD-në



3 Report Tv në fshatrat minoritare që po zbrazen në jug të vendit! Në Dërmish të Finiqit gjen vetëm të moshuar! Banorët: Na kanë ikur fëmijët, nuk kthehen se s'kanë punë! Ka humbur shpresa



4 Zbardhet skema e kalimit të 45 kg heroinë në Portin e Durrësit, si shpëtoi la hidhte akenerit duke ndërruar kokën e kamionit! Në burg drejtuesi dhe pronari



5 Rama poston video nga rezervuari i kultivimit të peshkut ton në detin Jon: Gati për tregun japonez

Kronikë

Nipi vret me armë gjahu xhaxhanë në Vlorë dhe më pas veten! Autori dyshohet me probleme të shëndetit mendor! Shkak dyshohet sherri për pronën, të afërmit: Shkonin shumë mirë bashkë

Një krim i dyfishtë është regjistruar mbrëmjen e sotme në Vlorë, ku nipi ka vrrarë xhaxhanë dhe më pas veten. Ngjarja e rëndë është regjistruar në fshatin Mekat të Vlorë, e ndërsa viktimat janë identifikuar si Genci Koreta, 39 vjeç (nipi) dhe xhaxhai Jorgji Koreta, 64 vjeç.



Redaksia

25 Tetor, 18:44 | Përditësimi i fundit: 26 Tetor, 11:19



VLORË- Një krim i dyfishtë është regjistruar mbrëmjen e sotme në Vlorë, ku nipi ka vrrarë xhaxhanë dhe më pas veten.

Ngjarja e rëndë është regjistruar në fshatin Mekat të Vlorë, e ndërsa viktimat janë identifikuar si Genci Koreta, 39 vjeç (nipi) dhe xhaxhai Jorgji Koreta, 64 vjeç. I riu, i cili paraparkisht dyshohet se vuante nga depresioni, ka qëlluar me armë gjahu xhaxhanë teksa po punonin në ullishte, e ndërsa mendohet se shkak ka qenë një konflikt për pronën.



LEXO EDHE:
Report Tv në fshatrat minoritare që po zbrazen në jug të vendit! Në Dërmish të Finiqit gjen vetëm të moshuar! Banorët: Na kanë ikur fëmijët, nuk kthehen se s'kanë punë! Ka humbur shpresa

Report Tv me gazetarin Armand Xhelili ka komunikuar me disa prej të afërmmve, të cilët pyetur nëse autori ishte me probleme të shëndetit mendor, e kanë mohuar duke thënë se 39-vjeçari ishte shëndosh e mirë. Ata kanë deklaruar se autori dhe viktima shkonin shumë mirë me njëri-tjetrin dhe se nuk kanë qenë në dijeni të konflikteve të mëhershme. Të afërmit shprehen se kanë mbetur të shokuar nga kjo vrasje, teksa theksojnë se nuk kanë pasur dijeni që i riu kishte armë në banesë.

Siç shihet në pamjet që Report Tv sjell, ambulanca ka mbërritur për të tërhequr trupat e pajetë të nipit dhe xhaxhait, të cilët janë transportuar për në morgun e spitalit të Vlorës. Grupi hetimor ka sekuestruar edhe armën e gjahut me të cilën 39-vjeçari ekzekutoi xhaxhain dhe më pas veten.



Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit!**

Ora 19:43

Nipi vrau xhaxhanë në Vlorë dhe më pas veten, të afërmit: Shkonin shumë mirë bashkë!

Dëgjuam ulërimën e së ëmës dhe erdhëm me vrap

Djali i hallës së 64-vjeçarit, Jorgji Koreta, tregon se nipi e ka qëlluar teksa ishin duke punuar te ullinjtë, e ndërsa sipas tij të dy shkonin shumë mirë me njëri-tjetrin.

"Ne tani e morëm vesh, nuk e dimë pse u vranë, te ullinjtë punonin nipi me xhaxhanë, nuk e dimë a kanë pasur më parë konflikte, ata kalonin mirë", tregon ai.

Një tjetër i afërm tregon se viktimat nuk kanë pasur konflikt me njëri tjetrin.


"Ishin duke mbledhur ulla, nuk kishin konflikt fare", tregon një tjetër i afërm.

"Dëgjova të ëmën që po ulërinte dhe erdha. Ishte djalë me të gjitha cilësitë, ishte i pamartuar, xhaxhai rri në Vlorë me shtëpi. Ai skuqej kur të fliste me gojë, jo më debate, s'kanë pasur asnjëherë konflikt për pronën, ai një copë toke, si xhaxhai jeton në Vlorë, xhaxhai kishte ardhur për të parë pronën e tij, nuk e dimë gjë për armën", ka treguar ajo.



Ora 18:57

Krimi në familje në Vlorë, zbardhet identiteti i 2 viktimave



Zbulohet identiteti i viktimave në Vlorë. Mësohet se viktima kanë mbetur nipi, i identifikuar si Genci Koreta, 39 vjeç dhe xhaxhai Jorgji Koreta, 64 vjeç.



B.K./J.SH./Shqiptarja.com

TAG: Vlore, policia e vlorës, krim në familje, Genci Koreta, Jorgji Koreta

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:

A mendoni se ndryshimet e fundit në Policinë e Shtetit do të sjellin rezultate pozitive në luftën ndaj krimit?

PO JO Nuk kam mendim

Komento

Komente

Selamiu: 25/10/2021 18:58
Ca u fitua ne kte mes?

Përgjigju

Pellazgu: 26/10/2021 02:58
U bene te famshem ne tv.


Lajme të tjera

Kronikë




Bënte 'kërdinë' në Vlorë, arrestohet 32-vjeçari, autor i vjedhjes së 11 banesave
30 Tetor, 13:40

Shëndeti



5-vjeçari në Sarandë humbi jetën 4 ditë më parë nga COVID, i ati: Më thoshin që kishte virozë, mushkëria i kishte dalë jashtë zhvillimit
30 Tetor, 13:30

Sociale



Rama tha se punimet për aeroportin nisin më 28 nëntor, banorët e Akërnisë: Aeroporti i ri i Vlorës do sjellë zhvillim
30 Tetor, 12:59

Kronikë



Roja bie aksidentalisht nga kati i 15 në katin e 14, ndërrohet jetë në vend 63-vjeçari në Sarandë
30 Tetor, 11:27

Kronikë



U kap me 35 kg marijuanë në banesën në Konispol, prokuroria 'zbërthen' të dhënat në telefonin e autorit
29 Tetor, 22:09

Kronikë



Ndodh në Sarandë/ Nipi: Lironi dajën, drogën e mbolla unë! Gjyqtari liron nga qelia 60-vjeçarin
29 Tetor, 16:09